



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
MINISTRI

UDHËZIM

Nr. 5, datë 22.4.2015

PËR
PROCEDURËN DISIPLINORE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 13, pika 2, shkronja “f” të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 24, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZ O J:

I. Objekti dhe qëllimi

Udhëzimi për procedurën disiplinore në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përcakton mënyrën e zbatimit në praktikë të parimeve, normave dhe kërkesave në fushën e disiplinës, në funksion të respektimit të të drejtave të njeriut dhe zbatimit të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

II. Ecuria disiplinore

Ecuria disiplinore përfshin:

1. konstatimin dhe raportimin e shkeljes;
2. pezullimin disiplinor të ushtarakut në rastet kur pretendohet se ka kryer shkelje të rënda apo shumë të rënda disiplinore;
3. procedimin disiplinor nga ana e autoritetit përgjegjës për dhënien e masës;
4. dhënien ose jo të masës disiplinore të ushtarakut që procedohet disiplinarisht;
5. ankimin për masat disiplinore;
6. administrimin e masës disiplinore.

III. Raportimi i shkeljes disiplinore

1. Raportimi i shkeljes është faza fillestare e një procedimi disiplinor. Për qëllimin e këtij udhëzimi, raportimi i shkeljes është një fazë që fillon me konstatimin e shkeljes dhe përfundon kur arrin në autoritetin përgjegjës për dhënien e masës disiplinore.
2. Raportimi bëhet sipas formularit standard të miratuar nga Ministri i Mbrojtjes.

3. Në zyrat e informacionit/në postbllok/në trupprojë/oficer roje, të të gjitha strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura mbahen formularë të raportimit të shkeljes, të cilët i vihen në dispozicion çdo personi që kërkon të bëjë një raportim për një shkelje disiplinore. Pas plotësimit, raporti protokollohet dhe një kopje i jepet menjëherë personit që bën raportimin.

IV. Afati maksimal për raportim

1. Raportimi i shkeljes së lehtë ose të rëndë disiplinore nuk mund të bëhet nëse kanë kaluar dymbëdhjetë muaj nga data e shkeljes.
2. Raportimi i shkeljes shumë të rëndë disiplinore nuk mund të bëhet nëse kanë kaluar njëzet e katër muaj nga data e shkeljes.

V. Mënyrat e raportimit

1. Raportimi i shkeljes mund të bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, një ushtarak i rastësishëm apo një civil.
2. Kur raportuesi është eprori i drejtpërdrejtë ai thërret ushtarakun shkelës dhe i jep me shkrim njoftimin e shkeljes sipas formularit VPD Model-1, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë e pandarë e tij.
Në rastin e shkeljeve të rënda ose shumë të rënda disiplinore eprori i drejtpërdrejtë përveç njoftimit sipas formularit përkatës raporton shkeljen tek eprori i vet dhe ky i fundit vazhdon raportimin deri sa të arrijë tek autoriteti më i ulët përgjegjës për ndëshkim me masë të rëndë apo shumë të rëndë disiplinore sipas rastit.
3. Në rastin e një ushtaraku të ndryshëm nga eprori i drejtpërdrejtë dhe nga i njëjti repart me ushtarakun shkelës ndiqet radha e mëposhtme:
 - a. raportohet tek eprori drejtpërdrejtë i ushtarakut shkelës;
 - b. eprori i drejtpërdrejtë vepron sipas pikës 2, të këtij Kreu.
4. Në rastin e një ushtaraku të një strukture të ndryshme nga ajo ku shërben ushtaraku shkelës ndiqet radha e mëposhtme:
 - a. ushtaraku që konstaton shkeljen plotëson formularin standard dhe e depoziton në sekretarinë e strukturës ku ai shërben, e cila e përcjell tek struktura e ushtarakut shkelës;
 - b. në momentin e mbërritjes së formularit të raportimit, në strukturën e ushtarakut shkelës, komandanti i strukturës thërret eprorin drejtpërdrejtë të ushtarakut, së bashku me ushtarakun shkelës;
 - c. komandanti i kërkon eprorit të drejtpërdrejtë të ushtarakut shkelës, të përgatisë formularin e njoftimit të shkeljes disiplinore, sipas formatit VPD Model-1, dhe t'i dorëzojë një kopje ushtarakut shkelës;
 - ç. në rastin e shkeljeve të rënda eprori i drejtpërdrejtë raporton shkeljen tek autoriteti përgjegjës për dhënien e masës disiplinore;
 - d. në rastin e shkeljeve shumë të rënda, komandanti i repartit raporton zyrtarisht tek eprori i tij i drejtpërdrejtë. Raportimi duhet të vazhdojë në linjë hierarkike tek Shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA ose Ministri i Mbrojtjes. Në këtë rast formulari VPD Model-1 përpilohet nga Komandanti i Forcës ose i strukturës mbështetëse dhe një

kopje i jepet ushtarakut shkelës. Në rastin e ushtarakëve shkelës me funksione në Ministrinë e Mbrojtjes apo në strukturat e varësisë të drejtpërdrejtë të saj, formulari i njoftimit plotësohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA.

5. Në rastin kur shkelja raportohet nga një civil atëherë ndiqet radha e mëposhtme:
 - a. në rastin kur civil i është nëpunës i Forcave të Armatosura ose Ministrisë së Mbrojtjes ai plotëson formularin standard dhe e depoziton në sekretarinë e strukturës ku ai shërben, e cila e përcjell tek struktura e ushtarakut shkelës. Në momentin e mbërritjes të formularit, të raportimit, në strukturën e ushtarakut shkelës ndiqet procedura e përcaktuar në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 4, të këtij Kreu;
 - b. në rastin kur civil i nuk është nëpunës i Forcave të Armatosura apo Ministrisë së Mbrojtjes, atëherë ai raporton shkeljen e pretenduar të ushtarakut në Policinë Ushtarake, ose në strukturën më të afërt të Ministrisë së Mbrojtjes ose Forcave të Armatosura. Sekretaria e strukturës ku është depozituar raportimi e përcjell atë tek struktura e ushtarakut shkelës. Në momentin e mbërritjes të formularit, të raportimit, në strukturën e ushtarakut shkelës ndiqet procedura e përcaktuar në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d” të pikës 4, të këtij Kreu.

VI. Pezullimi disiplinor

Pezullimi disiplinor kryhet në përputhje me nenin 20, të ligjit për disiplinën në FA dhe i jepet ushtarakut me shkrim.

VII. Procedimi disiplinor

1. Procedimi disiplinor përfshin një sërë veprimtarish të nevojshme për të vërtetuar fajësinë apo pafajësinë e një ushtaraku që pretendohet se ka kryer shkelje disiplinore.
2. Procedimi fillon menjëherë pasi ushtarakut i është dorëzuar formulari i njoftimit të shkeljes.
3. Në varësi të llojit të shkeljes dallojmë tre raste të procedimeve disiplinore:
 - a. procedim disiplinor për shkelje të lehta disiplinore;
 - b. procedim disiplinor për shkelje të rënda disiplinore;
 - c. procedim disiplinor për shkelje shumë të rënda disiplinore.

VIII. Procedimi disiplinor për shkelje të lehta dhe të rënda disiplinore

1. Të gjitha veprimet gjatë procedimit disiplinor kryhen nga autoriteti përgjegjës për dhënien e masës së lehtë ose të rëndë disiplinore.
2. Procedimi disiplinor nuk mund të zgjasë më shumë se 30 ditë. Për raste komplekse autoriteti përgjegjës për dhënien e masës mund të zgjasë deri në 15 ditë afatin e përfundimit të procedimit.
3. Ushtaraku ka të drejtë të parashtojë pretendimet e tij në lidhje me shkeljen nëpërmjet një formulari standard, i cili i dorëzohet ushtarakut bashkë me formularin e njoftimit të shkeljes.

4. Pretendimet parashtrohen sipas formularit VPD Model-2, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë e pandarë e tij.
5. Ky formular i dorëzohet autoritetit përgjegjës që jep masën disiplinore ndaj ushtarakut.
6. Veprimet që mund të kryhen gjatë procedimit disiplinor duhet të përfshijnë domosdoshmërisht formularin standard të raportimit të shkeljes si dhe formularët VPD Model-1 dhe Model-2.
7. Autoriteti përgjegjës merr vendim për dhënien ose jo të masës disiplinore.

IX. Procedimi disiplinor për shkelje shumë të rënda disiplinore

1. Për shkelje shumë të rënda disiplinore veprimet kryhen në përputhje me rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Lartë Disiplinor.
2. Në rastin kur autoriteti përgjegjës vendos për ngritjen e Komisionit të Lartë Disiplinor, momenti i njohjes me urdhrin nga ushtaraku i raportuar, merret si moment i nisjes së procedimit disiplinor.

X. Dhënia ose mosdhënia e masës disiplinore

1. Në përfundim të procedimit disiplinor autoriteti përgjegjës vendos për dhënien ose jo të masës disiplinore ndaj ushtarakut që procedohet.
2. Në të dy rastet vendimi jepet me shkrim dhe një kopje duhet t'i jepet ushtarakut brenda 48 orëve. Kopja tjetër qëndron në dosjen personale të ushtarakut dhe administrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Në rast se autoriteti përgjegjës vendos për dhënien e masës disiplinore, në përcaktimin e saj merren parasysh:
 - a. koha;
 - b. vendi;
 - c. shkaqet;
 - d. rëndësia e shkeljes;
 - e. shkalla e fajësisë;
 - f. rrethanat lehtësuese e rënduese;
 - g. pasojat e shkeljes disiplinore.
4. Masa e lehtë disiplinore, e dhënë nga niveli komandant toge ose kompanie, jepet sipas formatit të përcaktuar në formularin VPD Model-3, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë e pandarë e tij.
5. Momenti i marrjes së formularit VPD Model-3, nga ana e ushtarakut konsiderohet si moment i marrjes dijeni për masën e dhënë.
6. Masat e lehta të dhëna në nivel komandant batalionit e lart si dhe masat e rënda dhe shumë të rënda disiplinore jepen sipas rastit me urdhër ose dekret të autoritetit përgjegjës.

XI. Ankimi

1. Masa disiplinore mund të jetë e ankimueshme ose e pa ankimueshme administrativisht, sipas përcaktimeve të nenit 25, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
2. Ankimi mund të bëhet për shfuqizimin e masës së dhënë ose për dhënien e një mase më të lehtë.
3. Ankimi administrativ për masat e lehta të dhëna nga niveli komandant toge, kompanie ose batalioni, bëhet sipas formatit të përcaktuar në formularin VPD Model-4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë e pandarë e tij.
4. Ankimi administrativ bëhet brenda 10 ditëve nga momenti i marrjes dijeni për masën e dhënë.
5. Një kopje e formularit të ankimit, në rastet kur ligji parashikon ankim, i jepet ushtarakut bashkë me formularin ose urdhrin për dhënien e masës.
6. Ushtaraku nuk mund të pengohet në asnjë rast për të bërë ankimin.

XII. Masat disiplinore

1. Masat disiplinore për shkeljet e lehta disiplinore

a. Qortimi

- i. kjo masë i jepet ushtarakut në formë verbale;
- ii. qortimi i jepet ushtarakut në një ambient të veçantë duke ruajtur parimin e privatësisë;
- iii. kjo masë është më e lehta ndër masat e kësaj kategorie.

b. Detyra shtesë

- i. masa disiplinore e detyrës shtesë u jepet oficerëve me gradë jo më të lartë sesa Kapiten si ndëshkim, përveç detyrës së tyre të zakonshme;
- ii. kjo masë për oficerët nuk përfshin punë fizike;
- iii. për nënoficerët dhe ushtarët mund të jepen dhe detyra shtesë me punë fizike;
- iv. ushtarakut nuk i jepen detyra shtesë, të cilat përbëjnë rrezikshmëri për jetën dhe shëndetin e tij ose që cenojnë dinjitetin;
- v. detyra shtesë kryhet në njësinë ku shërben ushtaraku dhe duhet të jetë e matshme;
- vi. detyra shtesë duhet të jetë brenda aftësive fizike të ushtarakut ndaj të cilit merret kjo masë;
- vii. lloji i detyrës dhe afati për kryerjen e saj përcaktohen nga autoriteti përgjegjës për dhënien e masës, por nuk duhet të kalojë orarin zyrtar të punës.

c. Punë jashtë orarit

- i. ushtarakëve të Forcave të Armatosura u jepet si masë disiplinore punë e cila duhet të kryhet pas orarit zyrtar të punës;

- ii. në kuptimin e kësaj pike afati kohor, mbas orarit zyrtar të punës, është harku kohor nga momenti i përfundimit të orarit zyrtar të punës deri në orën 24:00 të së njëjtës ditë;
- iii. puna jashtë orarit jepet vetëm në ditët zyrtare të punës, është pa të drejtë page dhe nuk mund të zgjasë më shumë se 4 orë të pandërprera;
- iv. puna konkrete, afati dhe mënyra për kryerjen e saj përcaktohen nga autoriteti përgjegjës për dhënien e masës;
- v. puna konkrete duhet të jetë brenda aftësive fizike të ushtarakut ndaj të cilit merret kjo masë;
- vi. ushtarakut nuk i jepen punë, e cila përbën rrezikshmëri për jetën dhe shëndetin e tij ose që cenon dinjitetin.

2. Masat disiplinore për shkeljet e rënda disiplinore

a. Vërejtje me shkrim

Është masa disiplinore e cila jepet ushtarakut, si masa më e lehtë ndër masat e kësaj kategorie.

b. Kufizimi i lëvizjes në kufij të përcaktuar

- i. kufizimi i lëvizjes në kufij të përcaktuar i jepet ushtarakut me urdhër të shkruar dhe ekzekutohet brenda kufijve të përcaktuar të strukturës ku shërben;
- ii. në urdhrin për masën disiplinore kohëzgjatja përcaktohet me orë por jo më shumë se 72 orë. Kjo masë kryhet në mënyrë të pandërprerë;
- iii. në rast se kufizimi i lëvizjes në kufij të përcaktuar kalon orarin zyrtar të punës duhet të përcaktohen ambientet ku do qëndrojnë dhe të drejtat për t'u trajtuar me ushqim;
- iv. ushtarakut që i jepet kjo masë kryen të gjithë detyrat e tij funksionale përveç rasteve kur në urdhër është përcaktuar ndryshe.

c. Ndalim disiplinor

- i. kjo masë përbën një kufizim fizik të ushtarakut;
- ii. kufizimi fizik i ushtarakut bëhet në ambient të mbyllur të përcaktuar për këtë qëllim brenda strukturës përkatëse;
- iii. kufizimi fizik i ushtarakut mund të bëhet dhe në dhomat e ndalimit disiplinor të Policisë Ushtarake kur kjo përcaktohet në urdhër nga autoriteti përgjegjës që ka dhënë masën disiplinore;
- iv. kohëzgjatja e ndalimit disiplinor përcaktohet në orë dhe jo më shumë se 72 orë;
- v. ushtarakët e ndaluar disiplinarisht gjatë orarit të ndalimit nuk kryejnë detyra ushtarake, përveç rasteve të situatave emergjente;
- vi. para ekzekutimit të masës së ndalimit disiplinor kryhet kontrolli shëndetësor i ushtarakut nga mjeku i strukturës. Nëse gjendja shëndetësore nuk lejon ekzekutimin e kësaj mase, me kërkesë të mjekut ekzekutimi shtyhet për një periudhë të mëvonshme.

ç. Gjorbitja në pagë

- i. gjorbitja në pagë është masa e ndalimit të një pjese të pagës pa të drejtë rimarrjeje deri në $\frac{1}{4}$ e pagës personale mujore si ushtarak;
- ii. në rast se kjo masë cenon minimumin jetik të të ardhurave të ushtarakut ajo mbahet e pjesshme deri në pagesën e saj të plotë;
- iii. gjorbitja në pagë është masa disiplinore më e rëndë ndër masat e kësaj kategorie.

3. Masat disiplinore për shkeljet shumë të rënda disiplinore

a. Vërejtje me paralajmërim

- i. ushtarakut i cili ka kryer një shkelje shumë të rëndë disiplinore i jepet masa e vërejtjes me paralajmërim për shkarkim nga detyra dhe lirim nga Forcat e Armatosura;
- ii. në çdo rast kjo masë duhet të jetë e motivuar dhe i jepet me shkrim ushtarakut;
- iii. kjo masë është më e lehta në kategorinë e masave të dhëna për shkelje shumë të rënda.

b. Ulja e pagës

- i. ushtaraku që ndëshkohet me këtë masë trajtohet me pagën e ushtarakut e deri një grade më të ulët sesa grada që mban;
- ii. kjo masë jepet në muaj por jo më shumë se për një vit.

c. Shkarkim dhe lirim nga Forcat e Armatosura

Masa ekstreme e cila mund t'i jepet një ushtaraku për shkelje shumë të rënda disiplinore është shkarkimi nga detyra dhe lirimi nga Forcat e Armatosura.

XIII. Administrimi i masave disiplinore

1. Të gjitha masat që i jepen ushtarakut të Forcave të Armatosura administrohen në dosjen personale të ushtarakut.
2. Eprori i drejtpërdrejtë mban praktikën disiplinore të ushtarakut në regjistër të sekretuar sipas formatit të përcaktuar në formularin VPD Model-5, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë e pandarë e tij.

XIV. Me këtë udhëzim të njihet i gjithë personeli i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.

XV. Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi të gjithë ushtarakët e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.

XVI. Ndjekin zbatimin e këtij udhëzimi Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe Komandantët e Forcave dhe Strukturave Mbështetëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

MIMI KODHELI

NJOFTIMI I SHKELJES DISIPLINORE

Nr. _____ Prot.

Datë __.__.____

I mbajtur sot në datë __.__.____, në _____ *(struktura ku bëhet njoftimi)* _____ sipas informacionit të marrë nga _____ *(gradë, emër, mbiemër, funksion i personit që raporton shkeljen)* u raportua se _____ *(gradë, emër, mbiemër, funksion i ushtarakut të raportuar)* _____, me datë __.__.____, ora _____, në _____ *(vendi ku është konstatuar shkelja)* _____ ka _____ *(përshkruhet shkelja disiplinore)* _____

Me këtë njoftim u njoh _____ *(gradë, emër, mbiemër, i ushtarakut të raportuar)* _____.

EPRORI I DREJTPËRDREJTË

MARRËSI I NJOFTIMIT

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

Shënim: Kur personi që ka kryer shkeljen disiplinore refuzon të firmosë, në njoftimin shënohet vendi, data, ora dhe shkaku i refuzimit të nënshkrimit.

**PRETENDIMET E USHTARAKUT NË PROCEDIM PËR SHKELJE TË LEHTË OSE
TË RËNDË DISIPLINORE**

Nr. _____ Prot.

Datë ____ . ____ . ____

Drejtuar: _____ *(gradë, emër, mbiemër, funksion i eprorit të drejtpërdrejtë)*

Unë i nënshkruari _____ *(gradë, emër, mbiemër, funksion i ushtarakut në procedim)*,
në lidhje me raportimin ndaj personit tim, për kryerjen e shkeljes disiplinore
(përshkruhet shkelja disiplinore)

mbi të cilën jam vënë në dijeni me njoftimin nr. _____, datë ____ . ____ . ____ deklaroj se:

Pranoj kryerjen e shkeljes së raportuar

PO **JO**

Nëse PO

_____ *(nëse dëshiron, ushtaraku plotëson me shkrim dore rrethanat lehtësuese)*

Nëse JO

_____ *(ushtaraku plotëson me shkrim dore pretendimet e tij)*

USHTARAKU NË PROCEDIM

(gradë, emër, mbiemër, firmë)

VENDIM

PËR MASË TË LEHTË DISIPLINORE

Nr. _____, Datë ____ . ____ . _____

Në përfundim të procedimit disiplinor në ngarkim të _____ (*gradë, emër, mbiemër, funksion i ushtarakut në procedim*) _____, për kryerjen e shkeljes së lehtë disiplinore
(*emërtesa e shkeljes*) _____

të përcaktuar në nenin 11, shkronja ____, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”,

dhe pasi konstatova se:

(*përshkruhet shkelja disiplinore e raportuar, rrethanat e ngjarjes, pretendimet e ushtarakut dhe provat, faktet e dëshmitë, nëse ka*) _____

VENDOSA:

(*shpalljen të pafajshëm dhe mosdhënien e masës disiplinore ndaj të proceduarit*)
_____ (*gradë, emër, mbiemër*) _____

(*shpalljen fajtor të të proceduarit* _____ (*gradë, emër, mbiemër*) _____ *dhe dhënien e masës disiplinore* _____ (*emërtesa e masës*) _____, *të përcaktuar në shkronjën _____, të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”*)

AUTORITETI PËRGJEGJËS

(*gradë, emër, mbiemër, firmë*)

(*funksioni*)

ANKIM**NDAJ DHËNIES SË MASËS SË LEHTË DISIPLINORE**

Nr. _____ Prot.

Datë ____ . ____ . ____

Drejtuar: _____ (gradë, emër, mbiemër)

_____ (funksion)

I nderuar Z. _____ (grada),

Unë i nënshkruari _____ (gradë, emër, mbiemër, funksion),
 Ju bëj me dije se me datë ____ . ____ . ____ më është komunikuar masa disiplinore
 “ _____ (emërtesa e masës) _____”, e dhënë nga
 eprori im _____ (gradë, emër, mbiemër, funksion).

Duke mos qenë dakord me masën disiplinore të dhënë ndaj personit tim si dhe bazuar në pikën 1,
 të nenit 25, të ligjit nr. 173/2014 “Për disiplinën në Forcat e Armatosura të Republikës së
 Shqipërisë” dhe në Kreun XI, të rregullores “Për procedurën disiplinore në Forcat e Armatosura
 të Republikës së Shqipërisë”, dëshiroj të parashtoj sa më poshtë:

_____ (përshkruhet shkelja disiplinore e raportuar, masa disiplinore e dhënë si dhe
 pretendimet e ushtarakut se pse kjo masë është e pambështetur në ligj dhe në prova)

Sa më sipër, kërkoj:

Shpalljen të pafajshëm dhe shfuqizimin e masës disiplinore “ _____ (emërtesa
 e masës) _____”, të dhënë ndaj personit tim.

Ndryshimin e masës disiplinore “ _____ (emërtesa e masës) _____”,
 të dhënë ndaj personit tim dhe dhënien e një mase më të lehtë disiplinore.

KËRKUESI

_____ (gradë, emër, mbiemër, firmë)

Shënim: Një kopje e kërkesës, pasi protokollohet, i jepet kërkuarit.

PRAKTIKA DISIPLINORE E USHTARAKUT**TOGA(ANIJA)** _____, **KOMPANIA** _____, **BATALIONI** _____

Gradë, Emër, Atësia, Mbiemër _____
 Ditëlindja _____
 Vendlindja _____
 Arsimimi _____
 Detyra _____
 Nr. Kartës identitetit _____
 Adresa _____

MASAT DISIPLINORE

Nr.	Lloji i shkeljes (referenca në ligj)	Data e konstatimit të shkeljes	Masa disiplinore e dhënë (referenca në ligj)	Data e masës së dhënë	Autoriteti që ka dhënë masën	Vërejtje
1.						
2.						
3.						
4.						
5.						
6.						